

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-237/14**

**Prishtinë,  
6 qershor 2015**

Në çështjen juridike të:

**Z. Đ.**

Në emër të gjyshit të tij

**V. Đ.**

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami Kryetar i Kolegjit, Gjyqtarët Anna Bednarek dhe Sylejman Nuredini anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/228/2014 lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave më tej AKP me numrin KPA13587 i datës 13 Mars 2014, pas seancës gjyqësore kryesore, të mbajtur më 9 qershor 2016, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesa e Z. Đ. e paraqitur kundër vendimit të KPCC /D/A /228/2014 sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA13587 i datës 30 Mars 2014, refuzohet si e pabazuar.
2. Konfirmohet vendimi i KPCC /D/A /228/2014 sa i përket lëndës së regjistruara në AKP me numrin KPA13587 i datës 30 Mars 2014

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 2 Tetor 2006, Z. Đ., ka parshtruar një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronave (më tej AKP) e regjistruar në nr. KPA13587 ,në cilësinë anëtarit të familjës së titullarit të së drejtës pronësore. Prona e kërkuar gjendet në parcelat nr. 111/1; 112; 115/1; 117 dhe 118 , zona kadastrale Zakut , Komuna e Podujevës me sipërfaqe prej 2 hektarë, 37 ari e 11 metra katrorë(më tej prona e kërkuar). Ai ka pohuar se gjyshi i tij V. Đ. si bartëse e së drejtës pronësore tani e ndjerë është pronar i paluejtshmerisë të cilën e ka blerë nga Kooperativa Bujqësore Kërpimeh/Krpimej në vitet e 60.
2. Sekretariati i Agjencisë Kosovare të pronave kishte formuar dy kërkesa duke mbajtur ate ekzistuese me numër KPA13587 për ngastrat 111/1; 112; 115/1; 117 dhe 118 dhe duke formuar kërkesën e re me numër KPA90451 për ngastrat 130; 131; 132 dhe 133. Sekretariati i AKP-së e kishte njoftuar paraqitësin e kërkesës me formimin e kërkesës së re me 5 Maj 2008.
3. Për ta mbështetur kërkesën e tij Z. Đ. ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:
  - Përshkrimin e listës poseduese nr.79 datë 20 Shkurt 1992 lëshuar nga Drejtoria Komonale Gjeodete Podujevë
  - Kontratë e shitblrejës Nr. 475 datë 28 tetor 1967 e lidhur në mes të Kooperativës Bujqësore të Kërpimeh/Krpimej si shitëse dhe gjyshit të paraqitësit të kërkesës V. D. e pa vërtetuar në Gjykatë.
  - Përshkrim i listës poseduese Nr. 79 lëshuar nga shërbimi për kadastër dhe paluejtshmeri në Podujevë me 5 Maj 1999.

- Përshkrim i listës poseduese Nr. 34 lëshuar nga Drejtoria Komunale e Gjeodete në Podujevë me 24 Dhjetor 1987 që dëshmon se prona e kërkuar ishte e evidentuar si pronë shoqërore e Kooperativës Bujqësore Kërpimeh/Krpimej.
  - Aktgjykim në mungesë i Gjykatës Komunale në Podujevë P.br.89/79 i datës 15 Janar 1979 që vërteton se V. Đ.me ankand publik të datës 28 Prill 1967 ka blerë pronën e kërkuar.
  - Propozim për përmbarrimin e aktgjykimit drejtuar Gjykatës dhe lejim i përmbarrimit me numër 1159/79 datë 3 Tetor 1979
  - Aktvendim mbi përcaktimin vijave kufizuese të ngastrave 113/2; 111/2 dhe 114 i datës Nr.192/82 datë 23 Qershor 1983
  - Aneks kontratë Nr.990 datë 5 Qershor 1968 që dëshmon se për shkak të kontestimit të një pjese të tokes ka vështirësi në regjistrimin e pronës në regjistra publik.
4. Ekipi i verifikimit i AKP-së sipas raportit të verifikimit të datës 09.02.2007, ka konstatuar që sipas fletës poseduese të theksuar prona e kërkuar është regjistruar si pronë shoqërore në emër të Kooperativës Bujqësore të Kërpimeh/Krpimej. Në raportin e datës 1 Qershor 2006 në kadastrën e zhvendosur në Serbi është verifikuar lista poseduese e parashtruar nga paraqitësi i kërkesës ku vërehet se prona e kërkuar është në emër të gjyshit të paraqitësit të kërkesës.
5. Më 16 Dhjetor 2008, AKP-ja ka bërë identifikimin e pronës duke vendosur një shenjë të vendi ku ndodhej ngastra, ku thuhet se prona është objekt i kërkesës dhe se palët e interesuara mund të paraqesin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve. Askush nuk ka paraqitur përgjigje ndaj këtij njoftimi. Më 22 Korrik 2010, AKP-ja përsëri e ka bërë njoftimin e kërkesës duke e publikuar në Gazetën e Njoftimeve nr. 5 dhe në Buletinin e zyrës për prona të UNHCR-it. Gazeta dhe Lista i janë dorëzuar edhe krytarit të fshatit Fadil Thaqi i cili u pajtua t'ia dorëzojë palëve të interesuara dhe në hyrje të fshatit Zakut. Të njëjtat publikime janë lënë në Gjykatën Komunale, Kuvendin Komunal, si dhe në disa zyre të autoriteteve kompetente komunale në Podujevë.
6. Me 18 Dhjetor 2013 Agjencia Kosovare e Pronave ka njoftuar Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (tani Agjencia Kosovare e Privatizimit) së parashtruesi i kërkesës Z.D. ka paraqitur kërkesë për pronën e cila gjendet në fshatin Zakut të Podujevës dhe se sipas të

dhënave publike është e evidentuar si pronë shoqërore e ish Kooperativës Bujqësore të Kërprimih/Krprimejt dhe rrjedhimisht është nën administrimin e Agjencisë.

7. Më datën 23 Dhjetor 2013 Agjencia Kosovare e privatizimit ka njoftuar Agjencinë Kosovare të pronave se ngastrat kadastrale 111/2; 12;115/1; 117; 118; 130; 131; 132 dhe 133 janë administruar nga ish ndërmarrja shoqërore ish Kooperativa Bujqësore e Kërprimih/Krprimejt dhe se që nga viti 1999 janë në administrim të Agjencisë Kosovare të privatizimit, më parë të Mirëbesimit. Në shkresë thuhet se në valën e 57-të të privatizimit janë shitur/privatizuar ngastrat kadastrale 117; 118; 130; 131; 132 dhe 133 duke e njoftuar se Agjencia Kosovare e pronave nuk ka jurdiksion mbi pronat e ndërmarrjeve shoqërore për të cilat ka kompetencë Agjencia e Privatizimit dhe rrjedhimisht edhe Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme për çështje të privatizimit
8. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronat e kërkuara, me vendimin e tij KPCC/228/2014 që i referohet lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA13587 i datës 30 Mars 2014 ka vendosur që kërkesa të hedhet, me arsyetim se paraqitësi i kërkesave fillimisht kishte deklaruar se e ka humbur poshdimin si pasojë e konfliktit të armatosur por në bazë të dokumentave të parashtruara dhe kërkimeve “ex officio” të Sekretariatit ka rezultuar se prona është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të privatizimit dhe i është nënshtruar procesit të privatizimit.

#### **Pretendimet ankimore:**

9. Z. D. në cilësinë e palës ankuese, në emër të gjyshit të ndjerë, vendimin e Komisionit e ka pranuar më 30 Korrik 2014, ndërkaq ankesë ka paraqitur më datë 013 Gusht 2014.

#### **Arsyetimi ligjor**

#### **Pranueshmëria e ankesave:**

10. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore sipas nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008) (në tekstin e mëtejme LPK), Gjykata lidhur me shqyrtimin e aktgjykimit sipas detyrës zyrtare dhe për shkaqet e cekura dhe jo të cekura në ankesë gjeti se ankesa është e pranueshme dhe e afatëshme :

11. Gjykata Supreme e Kosovës e konsideroi ankesën e ankueses si të afatshme sipas nenit 186 par. 1 lidhur me nenin 196 të LPK-së për arsye se pala ankuese vendimin e Komisionit e ka pranuar më 30 Korrik 2014, ndërkaq ankesë ka paraqitur më datë 013 Gusht 2014. Nga kjo mund të konstatohet se ankesën e ka paraqitur në afatit prej 30 ditësh të parashikuar me dispozitën e nenit 12 par. 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet se ankesa kundër vendimit të KPCC mund të ankimohet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit.

**Pretendimet Ankimore:**

12. Pala nakuese pretendon se prona e kërkuar është pronësi e gjyshit të tij bazuar në kontratat e shitblerjës dhe Aktgjykimit të Gjykatës kompetente të çështjës. Ai më tej pohon se nuk ka njohuri se prona e tij është administruar nga Agjencia e Privatizimit dhe se i është nënshtruar procesit të shitjes/privatizimit. Ankesa ka të bëjë me ngastrat 117 dhe 118 dhe pala ankuese e kundërshton vendimine Komisionit për faktin se konstatimi në paragrafin 19 të vendimit KPCC/228/2014 që i referohet lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA13587 i datës 30 Mars 2014 është i pasaktë sepse prona është humbur si rezultat i konfliktit të armatosur dhe i rrethanave që lidhen me të. Ai pretendon se prona e tij nuk ka pas status të pronës shoqërore dhe këtë e ka dëshmuar me dokumentat e bashkangjitur kërkesës. Edhe për kunder faktit se i është nënshtruar privatizimit ai dhe familja e tij e kanë humbur posedimin në qershor të vitit 1999 dhe për këtë arsye ai kërkon që Vendimi i Komisionit të shfuqizohet dhe Gjykata të vërtetoi pronësinë mbi pronën e kërkuar dhe të urdheroi kthimin e posedimit.

***Meritat e Ankesës***

13. Gjykata gjeti se Ankesa e parashtruar ndaj vendimit të Komisionit është e pa bazuar për faktin se Agjencia Kosovare e Privatizimit ka marr nën administrim në bazë të Ligjit Nr. 04/L-034 për agjencinë kosovare të privatizimit përpara (Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12) bazuar në nenin 5 ku parashihet se

- “Agjencia Kosovare e Privatizimit më parë e Mirëbesimit ka kompetenca ekskluzive që të administrojë: 1.1. ndërmarrjet në pronësi shoqërore, pavarësisht nëse i janë nënshtruar transformimit apo jo;
  - të gjitha asetet që ndodhen në territorin e Kosovës, pavarësisht a janë të organizuara si subjekte apo jo, të cilat kanë qenë pronë në pronësi shoqërore me ose pas 22 Marsit 1989, përveç rasteve të rregulluara sipas paragrafi 2. të këtij neni;
14. Juridiksioni i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme mbi këtë çështje është i bazuar në Ligjin Nr. 04/l-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit që parashihet në nenin 4. 1. ku thuhet se “Dhoma e Posaçme ka kompetencë ekskluzive mbi të gjitha rastet dhe procedurat në lidhje me fushat në vijim:
- kundërshtimi ndaj një vendimi apo ndonjë veprimi tjetër nga AKM-ja apo Agjencia, ndërmarrë në bazë të Rregullores së AKM-së, apo përkatësisht në bazë të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
  - kërkesa kundër një Ndërmarrjeje apo Korporate që pohohet të ketë lindur gjatë apo para kohës kur ajo Ndërmarrje apo Korporatë i është nënshtruar autoritetit administrativ të AKM-së, apo Agjencisë;
15. Më tej Juridiksioni i Dhomës së Posaçme qartësohet në nenin 4 pikën 1.5. thuhet se “kërkesa që pretendojnë një të drejtë, titull apo interes në lidhje me çfarëdo pasurie apo prone mbi të cilën Agjencia apo AKM-ja ka apo ka shpallur autoritetin administrativ; pronësinë e një Ndërmarrjeje apo Korporate; .. nëse një e drejtë, titull apo interes i tillë pohohet të ketë lindur gjatë apo para kohës kur ajo Ndërmarrje apo Korporatë i është nënshtruar autoritetit administrativ të AKM-së apo Agjencisë;

***Ankesa është e pa bazuar.***

16. Përfundimisht Gjykata gjeti se vendimi i Komisionit është i drejtë dhe se meritat e kërkesës fillimisht dhe të ankesës rrjedhimisht nuk janë shqyrtuar për faktin se prona është tjetërsuar me vendim të Organit të formuar posaçërisht me ligj dhe se rrjedhimisht hubja nuk mund të konsiderohet si pasojë e konfliktit të armatosur por si proces i privatizimit nga autoriteti përkatës.

17. Gjykata gjeti se pala ankuese gjegjësisht paraqitësi i kërkesës ka në disponim mjetet ligjore të parapara me Ligjin Nr. 04/l-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe se duhet drejtuar autoritetit kompetent.
18. Për këto arsye të lartëcekurat, në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

**Këshillë ligjore:**

Sipas 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit,**

**Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Sandra Gudaiytye, Referente e EULEX-**